

VENDIM
Nr.683, datë 5.10.2011

PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR.47, DATË 16.1.2008 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR PROGRAMIN E NXITJES SË PUNËSIMIT, NËPËRMJET
FORMIMIT NË PUNË”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 5 të nenit 9 të ligjit nr.7995, datë 20.9.1995 “Për nxitjen e punësimit”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në fund të pikës 4 të vendimit nr.47, datë 16.1.2008 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, shtohet fjalia me këtë përmbajtje:

“Gjatë periudhës së zbatimit të këtij programi, punëdhënësi nuk duhet të bëjë pushime nga puna, pa shkaqe të arsyeshme, të punëmarrësve të tjerë të punësuar më parë.”

2. Ngarkohen Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta dhe Shërbimi Kombëtar i Punësimit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha